



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 2081 prot.
12

Tiranë, më 23.02.2024

N J O F T I M

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”, Statutit të TKOBAP të miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin për pozicionin e punës Solist i Dytë Lirik (tenor) pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.**

Për t’i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për t’i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve, TKOBAP nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme.

Audicioni do të zhvillohet në **datën 25.03.2024, ora 14:00, në Hollin Koncertor** të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

-Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje të certifikuar nga shteti i tij;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Të gjithë artistët e interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion, duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP-së deri në datën 18.03.2024, ora 16:30:

1. Një letër shprehje interesi për vendin vakant;
2. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;

3. Vërtetim të gjendjes shëndetësore ose një dokument ekuivalent me të;
4. Vërtetim të gjendjes gjyqësore ose një dokument ekuivalent me të;
5. Fotokopje të diplomës dhe listë notash të noterizuar në shtetin përkatës (të ketë kryer studimet e larta në nivelin Master për kanto brenda ose jashtë vendit);
6. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose një dokument ekuivalent me të;
7. Jetëshkrim (Curriculum Vitae) bashkëngjitur me foto dhe dokumentacionin e nevojshëm që vërteton: veprimtarinë ndër vite të certifikuar, Master class-e, Work shop-e, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, tituj artistikë si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën e tij artistike për vendin vakant për të cilin aplikon.
8. Dokumentet që vërtetojnë njohurinë minimalisht të 2 gjuhëve të huaja, të detyrueshme anglisht dhe italisht.

Programi:

***Programi për konkurimin është interpretimi i roleve të plota (përzgjedhja e roleve për interpretimin nga kandidatët do të bëhet Komisioni i Vlerësimit) nga veprat e mëposhtme:**

La Bohème (Rodolfo)
Madama Butterfly (Pinkerton)
Lucia di Lammermoor (Edgardo)
L'Elisir d'amore (Nemorino)
Rigoletto (Il Duca di Mantova)
Macbeth (Macduff)

Shënim:

-Komisioni ruan të drejtën që të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.

-Nëse kandidatët nuk kanë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor do vendosë një shoqërues në piano në ditën e audicionit pasi të jetë lajmëruar minimalisht 3 javë përpara.

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën elektronike:
sekretaria@tkob.gov.al

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Abigeila Voshtina

